KIRFN Interpretimi 10
Raportimi Financiar i Ndërmjetëm dhe Zhvlerësimi

Referencat

- SNRF 9 *Instrumentat Financiarë*
- SNK 34 *Raportimi Financiar i Ndërmjetëm*
- SNK 36 *Zhvlerësimi i Aktiveve*
- SNRF 9 *Instrumentat Financiarë* (publikuar në tetor 2010)

Informacion Bazë

1 Një njësie ekonomike i kërkohet të vlerësojë emrin e mirë për zhvlerësimin në çdo datë raportimi dhe, nëse kërkohet, të njohë një humbje nga zhvlerësimi në këtë datë në përputhje me SNK 36. Megjithatë, në fund të një periudhe raportuese të mëpasme, kushtet mund të kenë ndryshuar, kështu që humbja nga zhvlerësimi mund të pakësohet apo mënjanohet nëse vlerësimi i zhvlerësimit ka qenë bërë vetëm në këtë datë. Ky Interpretim siguron udhëzim nëse humbje të tilla nga zhvlerësimi duhet ndonjëherë të anullohen.

2 Interpretimi merret me bashkëveprimin midis kërkesave të SNK 34 dhe njohjes së humbjeve nga zhvlerësimi në emrin e mirë në SNK 36 dhe efektin e këtij bashkëveprimi në pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore, të periudhës më pas.

Çështje

3 SNK 34, paragrafi 28 kërkon që një njësi ekonomike të zbatojë të njëjtat politika kontabël në pasqyrat e ndërmjetme financiare të saj ashtu si janë aplikuar në pasqyrat financiare vjetore të saj. Ajo gjithashtu konstaton se "shpeshtësia e raportimit të një njësie ekonomike (vjetor, gjashtëmujor, apo tremujor) nuk do të ndikojë në matjen e rezultateve të saj vjetore. Për të arritur këtë objektivë, matjet për qëllime të raportimit të ndërmjetëm do të bëhen mbi një bazë që nga fillimi i vitit deri ne momentin aktual."

4 SNK 36, paragrafi 124 përcakton se "Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për emrin e mirë nuk do të anullohet në një periudhë të mëpasshme."

5–6 [Fshirë]

7 Interpretimi merret me çështjen e mëposhtëme:

> A duhet një njësi ekonomike të rimarrë humbjet nga zhvlerësimi në emrin e mirë të njohura në një periudhë të ndërmjetme nëse nuk është njohur humbje apo është njohur një humbje më e vogël dhe këtë vlerësim të zhvlerësimit ta ketë bërë vetëm në fund të periudhës vijuese të raportimit?

Marrëveshje

8 Një njësi ekonomike nuk do të rimarrë një humbje nga zhvlerësimi të njohur në një periudhë të mëparshme të ndërmjetme në lidhje më emrin e mirë.

9 Një njësi ekonomike nuk do të zgjerojë këtë marrëveshje për analogji, në fusha të tjera me konflikt të mundshëm midis SNK 34 dhe standardeve të tjera.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

10 Një njësi ekonomike do të zbatojë Interpretimin për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Nëntor 2006. Zbatimi më i hershëm inkurajohet. Nëse një njësi ekonomike zbaton Interpretimin për një periudhë që fillon para 1 Nëntor-it 2006, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Një njësi ekonomike do të zbatojë Interpretimin për emrin e mirë në të ardhmen që nga data në të cilën ajo ka aplikuar për herë të parë SNK 36; Ajo do të zbatojë Interpretimin për investimet në instrumentat e kapitalit apo në aktivet financiare të mbajtura me kosto për të ardhmen që nga data në të cilën ajo ka aplikuar për herë të parë kriterin e matjes të SNK 39.

11 [Fshirë]

12 SNRF 9 Instrumentat Financiarë, i publikuar në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 1, 2, 7 dhe 8 dhe fshiu paragrafët 5, 6 dhe 11. Nëse zbaton SNRF 9 të publikuar në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

© Fondacioni SNRF-ve